



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 95 Akti

Nr. 114 Vendimi

Tiranë, më 11.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 8 mars 2019, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Seci**, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i cili kërkoj konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci, vëzhguesin ndërkombëtar, z. John Leonardo, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Dritan Seci, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, ushtron detyrën e gjyqtarit/ kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 2, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Roland Ilia dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1, datë 21.3.2018, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Dritan Seci, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjyqësor, komisionerin Roland Ilia. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. John Leonardo.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe grupi i punës në Inspektoratin pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklaram të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci.”*

Grupi i punës në Inspektoratin pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

- Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta të pasurisë, fshehje të pasurisë, deklaram të rremë si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
- Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptuese, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹Me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018, e përbërë nga 14 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2018, dërgohet raporti i grupit të punës të Inspektoratit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

- Nga hetimi i aftësive profesionale, pasi u hetua raporti i Inspektoratit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe denoncimet, subjekti i rivlerësimit u gjet “i aftë” duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 25.2.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua, më datë 25.2.2019, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shitesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

Në datën 4.3.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, paraqiti kërkesë për thirrje për t’u pyetur shtetasi A H, si përfaqësues i qiradhënësit në lidhjen e kontratave të qirasë, shtetasi M. L, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “MC I” sh.p.k., dhe të ballafaqohet me shtetasin B. M në lidhje me deklaratimet e tij për të provuar prapësimet dhe kundërshtuar rezultatet e hetimit paraprak.

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve bazuar në nenin 49, të ligjit nr. 84/2016, analizoi çështjen në tërësi, duke arsyetuar se:

1. Në lidhje me kërkesën e subjektit për pyetjen e shtetasit A. H, me cilësinë e përfaqësuesit të qiradhënësit në lidhjen e kontratave të qirasë, trupi gjykues e konsideroi të panevojshëm, referuar gërmës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi ky shtetas deklarimin e tij e ka materializuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.2.2019.

2. Në lidhje me kërkesën e subjektit për pyetjen e shtetasit M.L, me cilësinë e administratorit të shoqërisë “MC I” sh.p.k., trupi gjykues e konsideroi të panevojshëm, referuar gërmës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi ky shtetas deklarimin e tij e ka materializuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.3.2019.

3. Në lidhje me kërkesën e subjektit për ballafaqim me shtetasin B. M në lidhje me deklarimin e tij, trupi gjykues e konsideroi të panevojshëm, referuar gërmës “a”, të pikës 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi ky shtetas, deklarimin e tij e ka materializuar me deklaratën noteriale nr***, datë 11.3.2014, hartuar pranë noteres E.L, e cila, po ashtu, ka dërguar shpjegimet e veta në Komision.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 5.3.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, më datë 8.3.2019, ora 13.00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht së bashku me përfaqësuesin ligjor të zgjedhur prej tij, avokatin Neritan Shehu. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Dritan Seci ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tre kriteret: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni,

në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, më datë 26.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- b) Deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- d) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016 si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria “MC I” sh.p.k., shoqëria “V. I” sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të

tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor etj.;

- e) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: i) verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1⁴, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, më datë 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2.

1. Apartament banimi me sipërfaqe 76 m², ndodhur në lagjen “D”, Bajram Curri, Tropojë, nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, vol. 1, faqe **, blerë më datë 11.8.2012, sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 11.8.2012, me shitës E. H, me vlerë 2, 200, 000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit: kursime nga paga si gjyqtar në periudhën 2004 – 2012, në shumën 11, 562, 985 lekë.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-të⁵ në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur, ZVRPP-ja Tropojë ka konfirmuar se në emër të Dritan M. Seci (në bashkëpronësi) është regjistruar pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe 76 m², me nr. ***, e ndodhur në zonën kadastrale ***, në Bajram Curri. Kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 11.8.2012.

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

⁵Shiko në dosje shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2018, drejtuar zvrpp-ve në rrethe në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tropojë me nr. *** prot., datë 9.5.2018.

Referuar deklaratës periodike të pasurisë të vitit 2012, kur është deklaruar për herë të parë ky apartament, subjekti ka deklaruar si çmim blerjeje shumën 2, 100, 000 lekë.

Kontrata e shitblerjes e datës 11.8.2012, me shitës shtetasin E. H dhe blerës Dritan Seci dhe znj. D. A, pasqyron se çmimi i blerjes së këtij apartamenti është në vlerën 2, 200, 000 lekë. Sipas kontratës, pagesa e çmimit është kryer me lekë *cash* në dorë në këtë zyrë noteriale.

Në lidhje me mospërputhjen e deklaramit të çmimit të blerjes së apartamentit, subjekti ka shpjeguar se mospërputhja e deklaramit të çmimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 me atë të deklaratës “Vetting” është për shkak të një lapsusi të bërë nga ana e tij në deklaramin periodik të pasurisë për vitin 2012, por në deklaratën “Vetting” është pasqyruar saktësisht vlera e këtij apartamenti prej 2, 200, 000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me vlerën e mobilimit të apartamentit të mësipërm këto pesë vitet e fundit.

Ai ka deklaruar në përgjigjen e tij se: *“Shpenzimet për rikonstruksionin e apartamentit në Bajram Curri, arredimin, mobilimin e tij, gjatë kësaj periudhe mund të kenë shkuar në vlerën 1,000,000 lekë.”*

Komisioni, nisur nga fakti se subjekti nuk ka specifikuar në mënyrë të saktë ndarjen e shumës së shpenzuar për mobilim, ndër vite, për më tepër dhe të pashoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor, duke marrë në konsideratë blerjen e këtij apartamenti, më datë 11.08.2012, vlerën e mobilimit, logjikisht e ka ndarë në mënyrë të barabartë në vitet 2012 dhe 2013, duke i konsideruar dy vitet e para si periudhën kohore kur normalisht kryhen investimet bazike, siç janë ato në rikonstruksion dhe arredim, për të siguruar një jetesë normale.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni për sa i përket mungesës së të ardhurave të ligjshme sipas analizës financiare të hartuar nga Komisioni, ka deklaruar se: *“Shpenzimet për arredimin e apartamentit ndër vite kapin vlerën 1,000,000 lekë, dhe në asnjë rast në vitin 2012 këto shpenzime nuk kanë qenë 500,000 lekë... Ato janë bërë vit pas viti dhe në asnjë rast nuk e kanë kaluar shumën e 300,000 lekëve, për të cilën kam pasur dhe kam detyrim ligjor për deklaram. Këto shpenzime, pra, kanë të bëjnë me vlerën reale të pajisjeve të mobilimit të shtëpisë sime ndër vite dhe ndarja nga ana juaj në dy vite, është bërë në interpretim të gabuar të deklaramit tim.”*

Analiza financiare e vitit 2012

	ANALIZË FINANCIARE	2012
I	PASURI	2 232 932
	Apartament me sip. 76 m ² , në Bajram Curri	2 200 000
	Diferencë likuiditeti (likuiditet 31/12/12- likuiditet 31/12/11)	32 932
II	TË ARDHURA dokumentuar	2 507 720
	Të ardhura të dokumentuara Dritan Seci	1 247 725
	Të ardhura të dokumentuara bashkëshortja, D. A	1 259 995
III	SHPENZIME	832 606
	Shpenzime jetese	321 429
	Shpenzime arredimi, apartament	500 000
	Shpenzime udhëtimi	11 178
IV	Analiza e dokumentuar (II- I - III)	-557 818

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe ** m², të ndodhur në qytetin Bajram Curri, Tropojë, në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012, në vlerën prej 2,100,000 lekësh, kur në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.8.2012, çmimi është përcaktuar në vlerën 2, 200, 000 lekë.

Referuar burimit të krijimit të kësaj pasurie deklaruar, “kursime nga paga si gjyqtar 2004 - 2012, në shumën 11, 562, 985 lekë”, pavarësisht provave dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konfirmohet fakti se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2012, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në vitin 2012 në Bajram Curri dhe për të përballuar shpenzimet e kryera përgjatë këtij viti, duke rezultuar me një balancë financiare negative prej – 557, 818 lekë.

Në bazë të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore....”*

Konkluzion

- Në deklaratën periodike të vitit 2012 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të çmimit të blerjes së apartamentit në Bajram Curri, Tropojë, për vlerën 2, 100, 000 lekë, ndërkohë që në kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 11.8.2012 dhe në deklaratën “Vetting” çmimi është përcaktuar në vlerën 2, 200, 000 lekë.

- Subjekti dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve për vitin 2012 në shumën - 557, 818 lekë.
2. Ambient shërbimi, me sipërfaqe ***, ndodhur në lagjen “****”, në qytetin Bajram Curri, Tropojë, i paregjistruar, blerë nga shoqëria “V. I” sh.p.k., sipas kontratës së porosisë nr. ***, datë 27.12.2013, me vlerë 40, 900 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit:

- Kursime nga paga si gjyqtar për periudhën 2004 – 2013, në shumën 14, 394, 846 lekë.
- Pagat si ndihmës gjyqtar dhe përmbarues për periudhën 1996 – 2004, në shumën 2, 255, 727 lekë.
- Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes si farmacistë (person fizik) për periudhën 2009 – 2012, në shumën 2, 938, 983 lekë.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2013, në bazë të një kontrate porosie me vlerë 40, 900 euro.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi “të ardhura të siguruara nga pagat”. Ai ka deklaruar pagesën e këstit prej 13, 000 euro dhe detyrimin e mbetur në vlerën prej 27, 900 euro.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi, përveç të ardhurave nga paga sipas viteve, edhe të ardhura nga biznesi i bashkëshortes si person fizik “farmaci”.

Referuar kontratës së sipërmarrjes, në nenin 3 të saj, përcaktohet çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës, si vijon: *“Në momentin e lidhjes së kontratës, kësti i I-rë prej 13,000 euro dorëzohet jashtë zyrës noteriale, kësti i II-të në muajin mars 2014 në vlerën 17,000 euro, dhe kësti i III-të në momentin e dorëzimit të lokalit, në vlerën 10, 900 euro”*.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tropojë nuk konfirmohet regjistrimi i kësaj pasurie pranë kësaj zyre.

Në lidhje me pagesën e tre kësteve në favor të shoqërisë “V. I” sh.p.k., subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se kësti i I-rë është dorëzuar *cash* në dorë në vlerën prej 13,000 euro në momentin e lidhjes së kontratës, sipas mandatarkëtimit nr. 2, datë 27.12.2013, vlerë e arkëtuar nga znj. D. A. (S), kësti i II-të është dorëzuar *cash* në vlerën 17,000 euro, sipas mandatarkëtimit nr. *, datë 19.12.2014, vlerë e arkëtuar nga znj. D. A (S), ndërsa kësti i III-të është dorëzuar *cash* në vlerën 10, 900 euro sipas mandatarkëtimit nr. **, datë 10.12.2015.

Këto pagesa konfirmohen dhe nga shoqëria “V. I” sh.p.k., në bazë të deklaratës noteriale nr.***, datë 22.01.2019, me deklarues administratorin e saj z.M. I, ku janë bashkëngjitur dhe mandatpagesat përkatëse si vijon:

- Mandatarkëtim nr. *, datë 27.12.2013, nr. serie ***, shuma 13, 000 euro, kësti i I-rë, arkëtoi D. A;
- Mandatarkëtim nr. *, datë 19.12.2014, nr. serie ****, shuma 17, 000 euro, kësti i II-të, arkëtoi D. A;
- Mandatarkëtim nr. *, datë 10.12.2015, nr. serie ***, shuma 10, 900 euro, kësti III-të, arkëtoi D. A.

Komisioni ka hetuar në lidhje me ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, në pozicionin e gjyqtarit dhe shoqërisë “V. I” sh.p.k.

Nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë,⁶ rezulton se nga shtatë çështje gjyqësore të regjistruara pranë kësaj gjykate me palë shoqërinë “V. I” sh.p.k., për tre prej tyre të shortuara për t’u gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit ka dhënë dorëheqje nga gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit (dorëheqja është miratuar), ndërsa për katër çështjet e tjera, subjekti nuk ka qenë anëtar i trupit gjykues.

Duke iu referuar analizës financiare për vitin 2013 dhe 2014 rezulton se subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten e tij, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë ambientin e shërbimit në Bajram Curri në vitin 2013, si dhe për të paguar këstet përkatëse në vitet 2013 dhe 2014.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Nga komunikimi me subjektin e rivlerësimit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion të Komisionit, konfirmohet ekzistenca e kontratës së porosisë nr. *****, datë 27.12.2013, dhe pagesa e tre kësteve sipas mandatarkëtimeve të vëna në dispozicion nga shoqëria “V. I” sh.p.k.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për vitet 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë burime të ligjshme financiare për të kryer investime dhe shpenzime, duke rezultuar me balancë financiare pozitive, përkatësisht me vlerën + 1, 365, 939 lekë për vitin 2013 dhe më vlerën + 2, 178,463 lekë për vitin 2014.

Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit për të cilën Komisioni bëri një hetim të thelluar duke analizuar dokumentacionin e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, rezultoi se subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me shoqërinë “V. I” sh.p.k.

Konkluzion

⁶ Shiko në dosje përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nr. *** prot., datë 22.1.2019, së bashku me praktikën e dosjeve gjyqësore.

Komisioni, pasi pyeti subjektin e rivlerësimit dhe hetoi në lidhje me kontratën e porosisë, pagesën reale të kësteve të çmimit të blerjes së pasurisë, burimin e ligjshëm të të ardhurave, aftësinë paguese të subjektit dhe personit të lidhur me të, si dhe gjendjen e konfliktit të interesit, nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

3. Apartament banimi, me sipërfaqe 93 m² dhe ambiente të përbashkëta me sipërfaqe **m², si dhe vend parkimi me sipërfaqe 12.8 m², me adresë: Rr. “N.K, Y, Tiranë, i paregjistruar ende. Ky apartament është blerë nga shoqëria “MC F” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes nr.****, datë 14.7.2015, në vlerën prej 43,178 euro; ndërsa garazhi në vlerën 7,000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit:

- Kursime nga paga si gjyqtar në periudhën 2014 – 2016, në shumën 4,664,120 lekë.
- Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes si farmacistë (person fizik) për periudhën 2013 – 2015, në shumën 6,175,730 lekë.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer me zvrpp-të vendore, ZVRPP-ja Tiranë⁷ ka konfirmuar se kjo pasuri nuk rezulton ende e regjistruar në regjistrin hipotekor.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2015, ku ai deklaroi se ka paguar shumën prej 10,000 euro, dhe si burim krijimi të ardhurat *cash* shumën prej 1,400,000 lekë, të deklaruar në vitin 2014.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi: a) kursime nga paga si gjyqtar për periudhën 2014 – 2016, në shumën prej 4,664,120 lekë; b) Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes si farmacistë (person fizik i regjistruar në vitin 2009), për periudhën 2013 – 2015, në shumën prej 6,175,730 lekë.

Kontrata e sipërmarrjes, në nenin 3 të saj përcakton se pagesa do të kryhet me këste si më poshtë:

- Vlera 10,000 euro, me nënshkrimin e kësaj kontrate;
- Vlera 15,000 euro, më datë 31.3.2016;
- Vlera 15,000 euro, më datë 31.8.2016;
- Vlera 10,178 euro, më datë 31.12.2016.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar pagesën e shumës prej 10,000 euro, në deklaratën e pasurisë të vitit 2016, pagesën e shumës prej 15,000 euro dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj kësaj shoqërie vlerën prej 25,178 euro. Pagesat janë të dokumentuara me mandatpagesa në bankën “Intesa Sanpaolo”.

⁷ Shiko në dosje përgjigjen nr.*** prot., datë 18.5.2018, të ZVRPP-së Tiranë drejtuar Komisionit.

Nga korrespondenca e kryer nga Komisioni me shoqërinë “MC I” sh.p.k.,⁸ shoqëria ka konfirmuar se vlera e kontratës në total është 50,178 euro. Subjekti ka likuiduar shumat si vijon:

- Vlera 10,000 euro, likuiduar më datë 21.12.2015;
- Vlera 15,000 euro, likuiduar më datë 19.12.2016;
- Vlera 15,000 euro, likuiduar më datë 28.12.2017;
- Vlera 10,178 euro është ende e palikuiduar.

Nga korrespondenca e kryer me “UKT”-në Tiranë, konfirmohet se me gjeneralitetet Dritan M. Seci rezulton kontrata nr. ****, në Rr. “N. K”, pallati “MC I” sh.p.k., objekti **, shk. *, ap. **, k. *, Tiranë.

Ndërkohë, OSHEE-ja me shkresën e saj ka konfirmuar vetëm shtetasin Dritan Seci në instancën e Kukësit.

Komisioni ka hetuar dhe në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit të subjektit me shoqërinë “MC I” sh.p.k., administratorin e saj z. M. N. L, si dhe për shoqëritë “F. B & C. C” sh.p.k., “L” sh.p.k., dhe “MC I L” sh.p.k.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë,⁹ në përgjigje të saj ka konfirmuar se nuk ka vendim penal apo civil në lidhje me subjektet e sipërcituara.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Nga analiza financiare e kryer për vitin 2015 rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me bilance financiare pozitive në shumën 945,469 lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Komisionit nga shoqëria “MC I” sh.p.k., konfirmohet vërtetësia e kontratës së sipërmarrjes, pagesa e kësteve përkatëse sipas deklarimeve të subjektit, me burime të ligjshme financiare.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me situatën e konfliktit të interesit të subjektit me shoqërinë “M.C I” sh.p.k., administratorin e saj M. N. L si dhe shoqëritë “F. B & C. C” sh.p.k., “L” sh.p.k., dhe “M.C I L” sh.p.k., nuk ka rezultuar që subjekti të jetë gjendur në ndonjë situatë konflikti interesi.

Konkluzion

Komisioni, pasi hetoi në lidhje kontratën e sipërmarrjes, pagesën reale të kësteve të çmimit të blerjes së pasurisë, aftësinë paguese dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit dhe personit të lidhur me të, nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

4. Vlera e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në emër të subjektit dhe personit të lidhur me të.

⁸ Shiko përgjigjen e shoqërisë “MC I” sh.p.k., nr. ** prot., datë 24.12.2018, drejtuar Komisionit.

⁹ Shiko përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. ** prot., datë 14.1.2019, drejtuar Komisionit.

- Gjendje në llogari rrjedhëse të pagës si gjyqtar “Raiffeisen Bank” 402,443.88 lekë;
- Gjendje në llogari depozite të subjektit në “Raiffeisen Bank” 145.76 lekë;
- Gjendje llogarie e biznesit të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” 124,580.94 lekë;
- Gjendje llogarie rrjedhëse e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” 431,174.99 lekë;
- Gjendje *cash* në shtëpi 1.400.000 lekë.

Konkluzion

Nga hetimi i Komisionit rezulton se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin e vënë në dispozicion të Komisionit.

5. **Detyrim ndaj shoqërisë “MC I” sh.p.k.**, sipas kontratës së porosisë nr. ****, datë 14.7.2015, për blerjen e apartamentit në Yzberisht, Tiranë, në shumën 25,178 euro (bashkëlidhur kontrata e sipërmarrjes).

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer nga Komisioni me shoqërinë “MC I” sh.p.k.,¹⁰ shoqëria ka konfirmuar se vlera e kontratës në total është 50,178 euro. Subjekti ka likuiduar shumat si vijon:

- Vlera 10,000 euro, likuiduar më datë 21.12.2015;
- Vlera 15,000 euro, likuiduar më datë 19.12.2016;
- Vlera 15,000 euro, likuiduar më datë 28.12.2017;
- Vlera 10,178 euro është ende e palikuiduar.

Konkluzion

Nga hetimi i Komisionit rezulton se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin e vënë në dispozicion Komisionit.

- **Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur** me subjektin e rivlerësimit, bashkëshortja e tij, znj. D. A, në deklaratën e pasurisë – shtojca 2.

6. **Vendi i ushtrimit të aktivitetit të bashkëshortes së subjektit**, znj. D. A, deklarohet biznes “Farmaci”, si person fizik me NIPT K****C, me adresë në Rrugën “S. V”, lagjja “****”, Bajram Curri. Ambienti me sipërfaqe 40 m² ku

¹⁰ Shiko përgjigjen e shoqërisë “MC I” sh.p.k., nr. ** prot., datë 24.12.2018, drejtuar Komisionit.

ushtrohet aktiviteti, është marrë me qira. Biznesi është hapur në vitin 2009 në shumën 500,000 lekë marrë nga bashkëshorti.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) ¹¹ konfirmohet se shtetasja D. H. A figuron e regjistruar si person fizik me NIPT K****C, me objekt “Shitje me pakicë e medikamenteve farmaceutike”, regjistruar më datë 21.4.2009, me vend të ushtrimit të aktivitetit në qytetin Bajram Curri.

Bashkëshortja e subjektit ka ushtruar aktivitetin e saj në një ambient marrë me qira shtetasit A. Gj, referuar kontratave të qirasë të depozituara nga vetë subjekti si më poshtë:

- Kontratë qiraje nr. ****, datë 21.4.2009, me afat dyvjeçar me pagesë 7,000 lekë/muaj, me sipërfaqe 40 m²;
- Kontratë qiraje nr. ***, datë 3.1.2014, me afat njëvjeçar dhe me pagesë 20,000 lekë/muaj, me sipërfaqe 40 m²;
- Kontratë qiraje nr. ***, datë 1.4.2016, me afat njëvjeçar me pagesë mujore 5,000 lekë/muaj, me sipërfaqe 40 m².

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të vërtetojë me dokumentacion ligjor se përse mbetet e pambuluar me kontratë qiraje periudha 21.4.2011 deri në 1.1.2014, si dhe periudha 3.1.2015 deri në 1.3.2016; të japë shpjegime se në cilin vend është ushtruar aktiviteti privat “Farmaci” gjatë kësaj periudhe të pambuluar me kontratë; të shpjegojë se për cilën arsye i njëjti qiradhënës (A. Gj) për të njëjtin ambient, me të njëjtën sipërfaqe, dhe me të njëjtën adresë, në të tre kontratat që ju keni depozituar, ka aplikuar çmime të ndryshme (7,000 lekë, 20,000 lekë dhe 5,000 lekë).

Subjekti ka deklaruar se: *“Në fillim është nënshkruar kontrata e qirasë në datën 21.4.2009 me afat dyvjeçar, duke përcaktuar si qira mujore 7,000 lekë në muaj. Pas përfundimit të këtij afati nuk është nënshkruar formalisht një kontratë tjetër qiraje, por afati i saj është zgjatur në heshtje dhe bashkëshortja ime ka vijuar aktivitetin tregtar po në këtë ambient. Qiradhënësi A. Gj nuk jeton në Bajram Curri dhe gjatë periudhës 2011 deri në vitin 2014 nuk është paguar rregullisht vlera e qirasë për këtë ambient. Me nënshkrimin e kontratës në vitin 2014, afati i së cilës fillon me datën 1.1.2014, është rënë dakord mes palëve që çmimi në kontratë të ishte 20,000 lekë për të paguar kështu edhe vlerën e qirasë së mbetur pa paguar për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014. Kjo marrëdhënie ka vijuar deri në vitin 2016 duke u zgjatur afati i kontratës në heshtje nga të dyja palët, pas datës 1.1.2015.*

Duke qenë se ambienti prej 81.8 m², i porositur me kontratën e sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “V. I” sh.p.k., nuk kishte mbaruar, është nënshkruar përsëri kontratë qiraje me afat njëvjeçar në vitin 2016 me një vlerë 5,000 lekë në muaj, pasi personi fizik

¹¹ Shihni përgjigjen e QKB-së nr. *** prot., datë 21.5.2018, drejtuar Komisionit.

D. A (S) ishte në pritje të transferimit të aktivitetit të saj në ambientin e porositur dhe për të cilin kishte bërë edhe pagesën e kështit të fundit në dhjetor të vitit 2015.

Në lidhje me ndryshimin e çmimit , Ju sqaroj se në vitin 2014 pati një rritje çmimi nga ana e qiradhënësit dhe ne e kishim të pamundur të gjenim ambient tjetër, ndërsa në vitin 2016 ishte në përfundim ambienti i porositur sipas kontratës me shoqërinë “V. I” sh.p.k., dhe në këto kushte bashkëshortja ime i ka kërkuar qiradhënësit që nëse donte të vazhdonte kontrata e qirasë të vazhdonte me çmimin e dakordësuar në kontratë.

Duke qenë se qiraja që paguaja sipas kontratës së vitit 2016 ishte me vlerë të ulët, gjatë kësaj kohe jam marrë me përshatjen e ambientit sipas kushteve ligjore që kërkon licencimi i farmacive, si dhe arredimin e këtij ambienti të ri. Pas plotësimit të këtyre kushteve ne dolëm në ambientin e ri.”

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me këto mospërputhje ka deklaruar se: *“Siç Ju kemi sqaruar edhe në përgjigjet e mëparshme, kontrata për periudhën në fjalë është ripërsëritur në heshtje dhe nuk ka pasur ndryshim çmimi i cili ka qenë po ai i kontratës së mëparshme. Edhe për periudhën 3.1.2015 deri 1.3.2016 kontrata është rinovuar në heshtje, për sa më sipër bashkëngjitur këtyre shpjegimeve po ju dërgojmë edhe deklaratën noteriale nr. ***, të datës 28.2.2019 ku qiradhënësi konfirmon këtë deklaram dhe deklaramet e mija të mëparshme.”*

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqes

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kontratave të qirasë, konstaton se:

- Rezulton e pambuluar me kontratë qiraje, periudha e ushtrimit të biznesit nga ana e bashkëshortes nga 21.4.2011 deri në 3.1.2014. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me vlerën e qirasë së paguar gjatë kësaj periudhe;
- Rezulton e pambuluar me kontratë qiraje edhe periudha 3.1.2015 deri në 1.3.2016, për të cilën subjekti nuk ka dhënë sqarime;
- Dyshime për sa i përket qirasë mujore paguar të njëjtit qiradhënësi me çmime të ndryshme në vite të ndryshme me diferenca të konsiderueshme për të njëjtin objekt dhe për të njëjtën sipërfaqe shfrytëzimi;
- Ndryshimi i çmimit të qirasë nga ana e qiradhënësit, të cilën subjekti e shpjegon sipas skemës kërkesë/ofertë, nuk është bindës për Komisionin përpos deklaramit të subjektit se kontrata e qirasë e vitit 2014 është paguar me qira mujore 20,000 lekë/muaj (pasi në periudhën 2011 deri 2014 qiraja mujore nuk është paguar e rregullt sepse qiradhënësi nuk ka jetuar në Bajram Curri dhe ky çmim do të kompensonte atë të munguar).

Ky fakt nuk është i përcaktuar në kontratën e qirasë të vitit 2014 me specifikimet e deklaruara nga subjekti, madje në këtë kontratë nuk është përmendur se sa është çmimi bazik dhe sa është ai që kompensohet çdo muaj.

Konkluzion

Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit, nuk i gjeti ato të bazuara dhe bindëse në lidhje me diferencat në çmimin e qirasë për të njëjtën sipërfaqe shfrytëzimi çka përforcohet me mungesën e lidhjes së kontratës së qirasë për periudha të gjata kohore, mbi një vit, sikurse parashikohet në nenin 803 të Kodit Civil.

7. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga aktiviteti “Farmaci”. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, për personin fizik D. A, “Farmaci”, ka të dhëna tatimore referuar qarkullimit, fitimit para tatimit dhe fitimit neto për periudhën 2011 – 2017.

Në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, D. A, ka deklaruar të ardhurat nga biznesi i saj si person fizik “Farmaci”, për periudhën 2009 – 2016, në shumën prej 10, 914,659 lekë, si më poshtë:

Viti 2009	Fitimi 380,000 lekë	Viti 2014	Fitimi 1,900,928 lekë
Viti 2010	Fitimi 394,000 lekë	Viti 2015	Fitimi 2,987,784 lekë
Viti 2011	Fitimi 904,988 lekë	Viti 2016	Fitimi 1,800,000 lekë
Viti 2013	Fitimi 1,286,964 lekë		

Totali 10, 914, 659 lekë

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ka konfirmuar se shtetasja D. H. A figuron e regjistruar si person fizik, me NIPT K*****C, me objekt “Shitje me pakicë e medikamenteve farmaceutike”, më datë 21.4.2009, me vend të ushtrimit të aktivitetit në qytetin Bajram Curri.

Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës¹² ka vënë në dispozicion të Komisionit informacion në lidhje me qarkullimin, fitimin para tatimit dhe fitimin neto për personin fizik D. A, “Farmaci”, për periudhën 2011 – 2017, duke dhënë sqarime edhe në lidhje me të dhënat tatimore për këtë subjekt.¹³

Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës,¹⁴ në lidhje me të ardhurat e tatueshme për vitet 2009 dhe 2010, rezulton se xhiroja e deklaruar për vitin 2009 është në shumën 2,000,000 lekë dhe për vitin 2010 është deklaruar xhiro në shumën 4,000,000 lekë, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹² Shiko përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, nr. *** prot., datë 29.5.2018, drejtuar Komisionit.

¹³ Shiko në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 18.2.2019, drejtuar Komisionit.

¹⁴ Shiko përgjigjen në dosje, nr. *** prot., datë 24.12.2018, drejtuar Komisionit.

Nga korrespondenca e kryer me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,¹⁵ rezulton se vlerat e rimbursimit për subjektin D. A, me NIPT K****C, me aktivitet “Farmaci”, janë si vijon:

Viti 2009 -1, 266, 638 lekë; Viti 2010 -5,066,181 lekë; Viti 2011 -7,979,442 lekë.

Diferenca mes deklarimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore, deklaratën “Vetting” dhe vërtetimit të DRT-së.

PËRSHKRIMI	2009	2010	2011	2012	2013
Të ardhura të deklaruara ndër vite nga D.A, person fizik	2, 000, 000	3, 000, 000	2, 500, 000	2, 500, 000	2, 000, 000
Xhirot sipas DRT-së Kukës, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.19	2, 000, 000	4, 000, 000	24, 299, 891	17, 843, 460	19, 583, 988
Fitimet e deklaruara në deklaratën “Vetting” nga D.A, person fizik	380, 000	394, 000	904, 988	1, 259, 995	1, 286, 964
Rimbursimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor	1 266 638	5 066 181	7 979 442	nuk ka info	nuk ka info

PËRSHKRIMI	2014	2015	2016
Të ardhura të deklaruara ndër vite nga D. A, person fizik	1, 900, 000	2, 987, 784	1, 822, 245
Xhirot sipas DRT-së Kukës konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.19	22, 317, 298	18, 672, 228	24, 399, 251
Fitimet e deklaruara në deklaratën “Vetting” nga D A, person fizik	1, 900, 928	2, 987, 784	1, 800, 000
Rimbursimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor	nuk ka info	nuk ka info	nuk ka info

Referuar analizës financiare rezulton si më poshtë vijon:

	ANALIZË FINANCIARE	2009	2010	2011
I	PASURI	1, 020, 989	2, 002, 072	1, 998, 022

¹⁵ Shiko në dosje përgjigjen e FSDKSH-së, nr. **** prot., datë 15.2.2019.

	Diferencë likuiditeti (likuiditeti i vitit – likuiditeti i vitit paraardhës)	1, 020, 989	2, 002, 072	1, 998, 022
II	TË ARDHURA	1, 534, 695	1, 701, 038	2, 166, 512
	Të ardhura të dokumentuara Dritan Seci	1, 154, 695	1, 307, 038	1, 261, 524
	Të ardhura të dokumentuara bashkëshortja D. A.	380, 000	394, 000	904, 988
III	SHPENZIME	829, 659	354, 743	351, 855
	Shpenzime jetese	321, 429	321, 429	321, 429
	Shpenzime për hapje biznesi deklaruar në deklaratën “Vetting”	500, 000		
	Shpenzime udhëtimi	8, 230	33, 314	30, 426
IV	Analiza dokumentuar (II - I- III)	-315, 953	-655, 777	-183, 365

Komisioni në lidhje me sa është analizuar më lart, ka konstatuar se:

- Ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës si dhe nga Fondi i Sigurimit të Rimbursueshëm, për sa i përket të ardhurave nga aktiviteti tregtar;
 - Rimbursimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor (për vitin 2010) është më i lartë se xhiroja e deklaruar nga subjekti te Zyra e Tatimeve për këtë vit;
 - Ka mospërputhje deklarimesh mes deklaratave periodike vjetore, deklaratës “Vetting”, si dhe të dhënave të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës lidhur me xhiron vjetore dhe fitimin ndër vite duke sjellë dhe rritje të likuiditetit të deklaruar;
 - Vlerat e fitimit të marra në analizë për vitet 2009 – 2010, janë ato të deklaruara në deklaratën “Vetting” nga bashkëshortja e subjektit;
- Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me këto mospërputhje ka deklaruar se: *“Në lidhje me këto mospërputhje nuk ka pasur asnjë qëllim fshehje nga ana ime, pasi këto janë të dhëna të nxjerra nga ana e ekonomistit të biznesit. Deklarimet janë bërë në bazë të të dhënave të parashikuara dhe rimbursimet nuk janë të gjitha fitim. Këto të dhëna janë lehtësisht të verifikueshme pasi gjenden në regjistrat e tatim taksave dhe nuk ka asnjë mundësi që të fshihen nga ime, ndoshta mund të ketë ndonjë pasaktësi por nuk kanë qenë asnjëherë të qëllimshme”.*
- Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe rritjen e likuiditetit përgjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, përkatësisht në shumat -315 953 lekë, -655 777 lekë dhe -183 365 lekë.

KONSTATIME TË TJERA NGA KOMISIONI

8. Autoveturë, tip “Volkswagen Golf”, me targë TR ***, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2004, në vlerën 250,000 lekë.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni ka mbajtur korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe nga ky institucion¹⁶ është përcjellë dosja e mjetit me targë TR *** (sot me targë AA ***).

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2004 subjekti ka deklaruar automjetin, tip “Volkswagen Golf”, me targa TR ***, në vlerën 250,000 lekë.

Këtë automjet subjekti e deklaroi të shitur në deklaratën periodike vjetore të pasurisë për vitin 2006, me vlerën 200,000 lekë.

Subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin provues të blerjes dhe shitjes së automjetit.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja¹⁷, rezulton se mjeti tip “Volkswagen Golf” i vitit 1991, me kontratën e datës 30.4.2006, i është shitur nga Dritan Seci blerësit I. S për çmimin 200,000 lekë.

Me kontratën e shitblerjes datë 19.2.2005, ky mjet i është shitur nga A. S subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, për shumën 200, 000 lekë.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimi për sa i përket vlerës së çmimit të blerjes së këtij mjeti pasi në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, ka deklaruar se ka shitur këtë mjet me vlerën prej 250,000 lekë, ndërkohë që sipas kontratës së datës 30.4.2006 ky automjet rezulton i shitur me vlerën prej 200, 000 lekë.

Gjithashtu referuar deklarimit të automjetit, tip “Volkswagen Golf”, ky automjet rezulton i deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004, ndërkohë që referuar kontratës kur është blerë ky automjet, ai rezulton i blerë më datë 19.2.2005, pra, në vitin 2005.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka pranuar *se ka mospërputhje të çmimit të blerjes së automjetit të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, me çmimin e deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë, gjithashtu deklarimi i këtij automjeti në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të viti 2004 është bërë gabimisht nga ana e subjektit ndërkohë që duhej deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2005.*

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës**

Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, si dhe nga deklaratimet e vetë subjektit, rezulton se ka mospërputhje e çmimit të shitjes së këtij automjeti deklaruar nga subjekti në vlerën 250,000 lekë, krahasuar me

¹⁶ Shiko në dosje shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018 drejtuar Komisionit.

¹⁷ Shiko në dosjen e përcjellë nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018 drejtuar Komisionit. kontratën e shitjes së datës 30.4.2006 dhe kontratën e blerjes së këtij mjeti të datës 19.2.2005.

çmimin e shitjes të pasqyruar në kontratën e datës 30.4.2006, ku çmimi i pasqyruar rezulton të jetë 200,000 lekë.

Pasaktësi ka gjithashtu në deklaram për sa i përket faktit të deklarimit të blerjes së automjetit, tip “Volkswagen Golf” nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2004, ndërkohë që referuar kontratës së blerjes së këtij mjeti rezulton se ai është blerë në vitin 2005.

Konkluzion

Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë: i) të çmimit të blerjes së automjetit; ii) të automjetit në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2004 ndërkohë që automjeti rezulton i blerë më datë 19.2.2005.

9. Në lidhje me përdorimin e mjetit të tipit “Opel Vectra”, me vit prodhimi 1990, me targa AA **, në pronësi të shtetasit A.S si dhe të mjetit të tipit Daimler Chrysler (Mercedes-Benz) i tipit C**** me vit prodhimi 1998, me targë AA ****, me pronar A. S.**

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, gjatë komunikimit me Komisionin për deklarimin e çdo pasurie në përdorim, ka deklaruar se, nga viti 2009 deri në vitin 2016 ka përdorur një automjet të vitit 1998 me pronar A. S si dhe një mjet të vitit 2006, dhe aktualisht ka në përdorim një automjet të vitit 2007, me pronar B. M.

Komisioni ka kryer verifikimet përkatëse në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) www.amf.gov.al,¹⁸ nga ku ka rezultuar se, subjekti Dritan Seci rezulton përdorues i automjetit me targë AA *** e vitit 1990, me pronar A. S, për periudhën 2015 – 2018.

Gjithashtu, nga verifikimi po në këtë faqe zyrtare të AMF-së, subjekti Dritan Seci rezultoi edhe përdorues i mjetit me targë AA *** për periudhën 2012 – 2017 me pronar A. S.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të këtyre dy automjeteve, ka deklaruar se: *“Automjeti me targa AA *** me pronar A. S realisht nuk është përdorur nga ana ime, por vëllai im, shtetasi A. S e ka bërë policën e sigurimit me idenë se ky mjet mund të përdorej nga ana ime. Pavarësisht këtij fakti, nuk më është dashur ta përdor këtë mjet dhe kjo është arsyeja që nuk është deklaruar, pasi realisht nuk është përdorur asnjëherë nga ana ime dhe nuk ka pasur asnjë kontratë formale për përdorimin e tij.*

*Në lidhje me konstatimin se nuk kam deklaruar përdorimin e automjetit me targa AA *** me pronar A. S, ju sqaroj se ky automjet është i njëjti automjet me automjetin me*

¹⁸ Shiko në dosje materialin e printuar nga faqja zyrtare www.amf.gov.al në lidhje me automjetet me targa AA *** BM, si dhe automjetin AA ***

targë TR ***, me nr. shasië ***** viti i prodhimit 1998 me ngjyrë të zezë, por është ndryshuar targa nga ana e vëllait tim, pas hyrjes në fuqi të targave të reja. Në deklarin tim nuk është pasqyruar ky ndryshim targash, fakt të cilin po e sqaroj në përgjigje të këtij konkluzioni. Bashkëngjitur një kopje të certifikatës së pronësisë së mjetit ku vërtetohet se është i njëjti mjet me të njëjtin nr. shasië.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Konkluzion

Rezulton se subjekti ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, në lidhje me faktin e përdorimit nga ana e tij të dy automjeteve me të dhënat e mësipërme, përkatësisht me targat AA *** dhe AA ***.

10. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe ** m², deklaruar përdorur nga subjekti i rivlerësimit, me adresë: Rr. “Dritan Hoxha”, përballë *, pronë e shoqërisë “MC I” sh.p.k.**

Gjatë komunikimit me Komisionin, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 2014 – 2015 ka përdorur si tranzit, për nevoja familjare, një apartament me sip. *** m², i ndodhur në adresën: Rr. “Dritan Hoxha”, Njësia nr. *, përballë ***, Tiranë, pronë e shoqërisë “MC I” sh.p.k., me administrator M. L, i cili ia ka dhënë në përdorim gjatë lëvizjeve të subjektit për rreth një vit pa dokumentacion dhe pa deklaratë noteriale. Subjekti ka deklaruar se tek ky apartament ka paguar vetëm energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyen e përdorimit të këtij apartamenti, të vënë në dispozicion nga shtetasi M. L, për rreth një vit, pa asnjë pagesë, pa asnjë dokument, të shpjegojë marrëdhënien me shtetasin M. L, si dhe të vërë në dispozicion të Komisionit pagesat e faturave të energjisë elektrike dhe faturave të ujit.

Subjekti ka deklaruar se: *“Pas vitit 2013 bashkëshortja ime ka pasur disa probleme shëndetësore, të evidentuara pas lindjes së fëmijës. Ajo është trajtuar gjatë periudhës 2014 dhe 2015 dhe ka pasur nevojë për shërbim fizioterapie. Për këtë shkak kemi kërkuar një banesë që mund ta përdornim kryesisht për këtë qëllim. Gjatë kësaj periudhe kam kontaktuar me shtetasin M. L, me të cilin kam lidhje shoqërore, ortak dhe administrator i shoqërisë “MC I” sh.p.k. Me këtë shtetas kam biseduar lidhur me porositjen e një banese në një kompleks, që do fillonte të ndërtonte pasi kishte aplikuar për leje zhvillimi në Bashkinë e Tiranës.*

Gjatë bisedës kam biseduar lidhur me mundësinë e një ambienti që të mund ta përdorja përkohësisht. Kjo është edhe marrëdhënie që unë kam me shtetasin M. L. Ai kishte një apartament të lirë për ta shitur dhe që nuk e përdorte askush. Këtë apartament ai na e vuri në dispozicion me kushtin që ta përdornim deri sa t’i krijohet mundësia për ta shitur. Unë, siç dhe kam sqaruar më parë, kam paguar vetëm shpenzimet për ujë dhe

energji elektrike deri në momentin që apartamenti i është shitur shtetasit R. F, në datën 26.10.2015.”

Komisioni në korrespondencën me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) ka kërkuar informacion në lidhje me faturat e energjisë elektrike në emër të Dritan Seci, dokumentacionin ligjor që është depozituar pranë OSHEE-së për të lidhur kontratën e energjisë elektrike në emër të Dritan Seci, si dhe çdo dokument tjetër të depozituar në atë dosje.

OSHEE-ja, në përgjigje të kësaj kërkesë¹⁹ ka depozituar pranë Komisionit dokumentacionin respektiv:

- Formular ankesë/kërkesë nr. *** datë 17.1.2014, për ndryshim emri nga I. R në Dritan Seci, ku si dokumentacion shoqërues i kërkesës është depozituar një kontratë porosie dhe vërtetim nga firma;
- Kontratë porosie, datë 26.4.2008, e lidhur ndërmjet shoqërisë “MC I” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe porositës z. Dritan Seci, për blerjen e një apartamenti me sip. *** m² i ndodhur në “Rrugën e Durrësit, përballë ***-së, Laprakë, Tiranë. Apartamenti është porositur kundrejt çmimit 50,000 euro, nga të cilat kësti i parë prej 4,000 eurosh paguhet me lidhjen e kësaj kontrate, kurse likuidimi total do të bëhet më datë 15.5.2008. Kjo kontratë është noterizuar nga subjekti (vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin), me nr. *** rep., datë 17.1.2014, nga noter B. Gj. V, Tiranë;
- Kërkesë drejtuar CEZ Shpërndarje sh.a., nga z. M. L në cilësinë e administratorit të shoqërisë “MC I” sh.p.k., datë 18.12.2013, i cili kërkon kalimin e kontratës së energjisë nga z. I. R tek z. Dritan Seci;
- Kontratë sipërmarrjeje nr. ****, datë 26.10.2015, e lidhur ndërmjet shoqërisë “M C I” sh.p.k., sipërmarrëse dhe shtetasit R. F, në cilësinë e porositësit, për apartamentin e mësipërm (R. F ka hequr dorë nga apartamenti i ndodhur në Rr. “N. K”, me sipërfaqe *** m², i cili nga të dhënat duket se është apartamenti i porositur nga ana e tij në vitin 2015 i përshkruar në pikën 3);
- Faturë tatimore e energjisë elektrike, mars 2018 në emër të z. Dritan Seci, për kontratën me nr. C. ***

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin e kontratës së porosisë së datës 26.4.2008, e lidhur ndërmjet shoqërisë “M C I” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe porositës z. Dritan Seci, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 77 m² i ndodhur në Tiranë, ka deklaruar se: *“Është e vërtetë se është lidhur kontrata e porosisë, datë 26.4.2008, ku unë kam porositur apartamentin*

¹⁹ Shiko në dosje shkresën e OSHEE-së me nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Komisionit.

në fjalë dhe kam paguar shumën kapar prej 4000 eurosh, dhe sipas kontratës likuidimi i plotë i shumës do të bëhej datë 15.5.2008, por ky likuidim i kësaj shume nuk është bërë asnjëherë, e për rrjedhojë ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë time. Duke qenë se me pronarin e shoqërisë “M C I”, kam pasur dhe kam marrëdhënie miqësore, ky i fundit në atë kohë më tha se do të ndërtonte një kompleks tjetër dhe kështu që vendosa që të mos e blija këtë apartament dhe kur të ndërtonte kompleksin tjetër të blija apartamentin në rrugën “N. K”, Yzberisht, Tiranë.

*Në këto kushte, pronari i shoqërisë “M C I” më ktheu dhe shumën kapar prej prej 4000 eurosh të paguar nga ana ime, veprim ky që nuk është pasqyruar formalisht, për shkak se kjo ka qenë një marrëdhënie mes miqsh dhe është neglizhuar ana formale. Për shkak të kësaj miqësie e kam përdorur këtë apartament në vitin 2014 – 2015 pa qira, dhe kontrata e mësipërme është përdorur për lidhjen e kontratës së energjisë elektrike për lehtësi administrative, pasi formalisht nuk ishte revokuar. Sqarojmë se apartamenti në fjalë i është shitur nga shoqëria “M C I” shtetasit R. F, dhe me kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.10.2015, i cili për shkak të neglizhencës nuk ka bërë ndryshimin e kontratës së energjisë elektrike dhe të furnizimit me ujë. Aktualisht edhe këto kontrata janë në emër të pronarit të vërtetë të kësaj pasurie. Fakt i cili provohet edhe me dokumentacionin që ju kam dërguar në përgjigjet e pyetësorit të mëparshëm. Bashkëngjitur deklaratë noteriale nga shtetasi M. L.”*

Nga korrespondenca e kryer me ILDKPKI-në dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk rezulton e provuar ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit dhe shtetasit M. N. L, shoqërisë “M.* I” sh.p.k., “F. B& C” sh.p.k., “L” sh.p.k., “M* I.” sh.p.k., “M * I. L” sh.p.k.²⁰

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Referuar kontratës së porosisë së datës 26.4.2008, e lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe porositës z. Dritan Seci, objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i apartamentit me sipërfaqe ** m² i ndodhur në “Rrugën e Durrësit”, përballë ***-së, Laprakë. Çmimi i këtij apartamenti të porositur është 50,000 euro, ku subjekti ka deklaruar se ka paguar shumën kapar prej 4000 euro, dhe sipas kontratës likuidimi i plotë i shumës do të bëhej datë 15.5.2008.

Në pyetësorin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm përdorimin e këtij apartamenti për periudhën 2014 – 2015 dhe nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes. Gjithashtu, edhe në deklaratën periodike të vitit 2008, nuk rezulton që kjo kontratë sipërmarrjeje të jetë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion

Komisioni, referuar dokumentacionit ligjor dhe deklarimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pasurinë apartament me sip. *** m²

²⁰ Çështja e konfliktit të interesit është trajtuar dhe më sipër në faqen nr. 9 të këtij vendimi.

ndodhur në “Rrugën e Durrësit”, përballë ***-së. Laprakë, Tiranë si dhe pagesat përkatëse të kryera nga subjekti për këtë apartament në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2008 dhe në vijim.

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për sa i përket faktit se apartamenti i mësipërm është deklaruar vetëm në përdorim nga ana e subjektit për periudhën 2014 – 2015, në një kohë që për këtë apartament subjekti kishte lidhur një kontratë porosie që në vitin 2008.

11. Në lidhje me deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.3.2014, të hartuar përpara notere E. L, me adresë në Tropojë, me deklarues shtetasin B. M, i cili deklaron se i jep mikut të tij, Dritan Seci, shumën prej 20,000 euro pa kundërshtpërblim dhe pa kthim për nevoja familjare.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën e saj nr. *** prot., datë 10.5.2017, drejtuar ILDKPKI-së, konfirmon se në emër të shtetasit Dritan Seci ka raportime të kontratave noteriale, dhe konkretisht të deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.3.2014, të hartuar përpara notere E. L nga shtetasi B. M i datëlindjes 4.3.1971, dhe shuma e përfshirë në transaksion është 20,000 euro.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime se në çfarë rrethanash e ka njohur shtetasin B. M, përse nuk është deklaruar kjo shumë nga ana e subjektit, si dhe të shpjegojë llojin e investimeve/shpenzimeve të kryera me këtë shumë, etj.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se: *“Menjëherë pas marrjes së pyetësorit, jam interesuar pranë noteres E. A. L për të marrë një kopje të këtij akti noterial.*

*Në datën 26 janar 2019 më është vënë në dispozicion kopje e njëjtë me origjinalin e deklaratës noteriale me nr. ***, datë 11 mars 2014, lëshuar nga shtetasi B. M dhe vërtetuar nga notere E. L.*

*Kjo deklaratë noteriale nuk ka asnjë lidhje me mua personalisht, nuk kam asnjë njohje me shtetasin ***, që sipas të dhënave në aktin noterial është shtetas anglez, pasi ka bashkëlidhur edhe kopje të pasaportës të Mbretërisë së Bashkuar, lindur në Morinë, Kosovë.*

*Unë nuk kam njohje me këtë shtetas, nuk është miku im siç është shprehur ai në aktin noterial dhe nuk kam asnjë lidhje me shumën prej 20,000 (njëzet) mijë euro, që është deklaruar në atë akt. Me aktin noterial nr. ***, datë 11.3.2014, jam njohur vetëm me datën 26 janar 2019, kur më është vënë në dispozicion kopje e saj nga arkiva e noteres E. L. Pra, shumën prej 20,000 (njëzet mijë) euro, që është përmendur në aktin e mësipërme nuk e kam marrë, ndaj nuk e kam deklaruar. Ju deklaroj me bindje të plotë se këtë shtetas nuk e kam takuar asnjëherë në jetën time, e jo më të kem marrë prej tij shumën e cituar në këtë deklaratë”.*

Komisioni i ka kërkuar shpjegime noteres E. A. L në lidhje me deklaratën noteriale të nënshkruar nga shtetasi B. M.

Në përgjigjen e saj,²¹ notere E. L, ndër të tjera, ka deklaruar: “... në datën 11.3.2014 është paraqitur personalisht shtetasi B. M etj... Me kërkesën dhe prezencën e tij, shtetasi B. M ka kërkuar vetëdeklarimin e deklaratës noteriale duke qenë gjithë kohën prezent në zyrë dhe duke deklaruar vetë personalisht me zë/me fjalët e tij, nuk ka pasur diçka të shkruar, për përmbajtjen e deklaratës noteriale si më poshtë:

Unë, deklaruesi B. M, me vullnet të lirë dhe të plotë në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram të pavërtetë, deklaroj se nga të ardhurat e mia personale nga puna, i kam dhënë në formë ndihme, mikut tim z. Dritan SECI, shumën prej 20,000 (njëzet mijë) euro, në janar të vitit 2014. Kjo vlerë i jepet mikut tim Dritan Seci, pa kundërshpërblim dhe pa kthim, për t'i përdorur për nevojat e tij familjare.

Gjatë redaktimit të deklaratës noteriale, është pyetur nga ana ime (meqenëse deklarata ishte e njëanshme), se për cilin shtetas bëhet fjalë, ku më është konfirmuar nga deklaruesi se është miku im Dritan M. Seci, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.”

Komisioni, në korrespondencën me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe me Prokurorinë pranë kësaj gjykate, ka pyetur nëse shtetasi B. M ka pasur çështje civile apo penale në këto dy institucione për të vërtetuar situatë konflikti të mundshëm interesi apo lidhje të këtij shtetasi me subjektin Dritan Seci në pozicionin e gjyqtarit.

Nga përgjigjet e kthyer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë,²² si dhe nga Prokuroria²³ pranë kësaj gjykate, është kthyer përgjigje se nuk disponohen të dhëna në lidhje me vendim penal apo civil apo vendime të prokurorisë në lidhje me këtë shtetas.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të AMF-së, www.amf.gov.al rezultoi se mjeti me targë AA **** ka si pronar z. A. S, vëllai²⁴ i subjektit Dritan Seci, ndërsa vetë subjekti Dritan Seci rezulton si përdorues i këtij mjeti .

Komisioni verifikoi të dhënat në sistemin TIMS²⁵ për hyrje-daljet brenda dhe jashtë territorit shqiptar të shtetasit B. M dhe të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci.

Nga kërkimi i këtyre të dhënave nga sistemi TIMS,²⁶ rezultoi se shtetasi B. M rezulton me dalje nga territori shqiptar, në datë 12.7.2016 nëpërmjet pikës kufitare Qafë-Morinë

²¹ Shiko në dosje përgjigjen e detajuar të noteres E. L drejtuar Komisionit me rrugë elektronike, si dhe përgjigjen me shkresë dërguar me nr. extra prot., datë 9.2.2019.

²² Shiko në dosje shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë drejtuar Komisionit.

²³ Shiko në dosje shkresën nr***, datë 4.2.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë drejtuar Komisionit.

²⁴ Shiko në dosje tek pyetësi nr. 2 ndodhet certifikata familjare e vitit 1996 e depozituar nga vetë subjekti që vërtetohet se A. S është i vëllai i subjektit Dritan Seci.

²⁵ Shiko në dosje të dhënat e printuara nga sistemi TIMS për hyrje-daljet e shtetasit B. M dhe subjektit Dritan Seci.

²⁶ Shiko në dosje të dhënat e printuara nga sistemi TIMS për hyrje-daljet nga territori shqiptar për shtetasin B. M.

me automjetin me targë AA ***** i cili në këtë datë rezultoi të jetë në përdorim të subjektit të rivlerësimit z. Dritan Seci.

Nga kërkimi i këtyre të dhënave nga sistemi TIMS, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Dritan Seci rezultoi me dalje nga territori shqiptar me datë 8.7.2016 dhe 14.7.2016, nëpërmjet pikës kufitare Qafë-Morinë me automjetin me targë AA ***.

Nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS për shtetasin A. S, nuk rezultoi që ky shtetas të ketë patur hyrje-dalje në territorin shqiptar me mjetin në pronësi të tij, me targë AA *****.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin faktet e parashtruara më sipër në lidhje me mohimin e njohjes me shtetasin B. M dhe të mohimit të përfitimit të shumës prej 20,000 euro nga ky i fundit, ka deklaruar: *“Ju sqarojmë se noterja E. L në dijeninë time është e vetmja notere në qytetin e Bajram Currit dhe kjo është arsyeja që pothuajse të gjitha veprimet e mija janë kryer te kjo notere. Së dyti, Ju sqaroj edhe njëherë se me shtetasin B. M nuk kam asnjë njohje dhe asnjë kontakt. Deklarata e bërë nga ana e tij është e njëanshme dhe nuk provon në asnjë situatë se unë kam marrë nga ai shumën e pretenduar në këtë deklaratë. Sipas logjikës së kësaj deklarate çdokush mund të bëjë një deklaratë të tillë, mund të vendosë çfarëdolloj shume, por kjo kurrsesi nuk mund të provojë faktin se një gjë e tillë ka ndodhur vërtetë. Në mënyrë hipotetike një gjë e tillë mund ti ndodhë kujtdo edhe ju të nderuar anëtarë të Komisionit ku një i panjohur mund të deklarojë para noterit se ju ka dhënë këtë apo atë shumë pa dijeninë Tuaj.*

*Në lidhje me faktin se personi në fjalë rezultoi të ketë udhëtuar me automjetin me targë AA ***** në pronësi të vëllait tim i cili është përdorur nga ana ime, Ju sqarojmë se më rezultoi se ky automjet përveç meje është përdorur edhe nga persona të tjerë të cilët janë, shtetasit A. S sipas kontratës nr. *** rep., A. C sipas kontratës për përdorim mjeti nr. *** rep., datë 2.10.2011, shtetasi A. M sipas kontratës nr. ***, kontrata të cilat po jua dërgojmë bashkëngjitur. Ju sqaroj edhe një herë se nuk i di rrethanat në të cilat ky shtetas ka udhëtuar në makinën e vëllait tim të cilën e kam përdorur edhe unë dhe as arsyet e rrethanat se përse ai e ka bërë një deklaram të tillë. Jam i gatshëm në çdo kohë dhe kërkoh të ballafaqohem me këtë shtetas në lidhje me këto deklarime të pavërteta të bëra nga ana e tij në adresën time.”*

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Konkluzion

Komisioni, pavarësisht deklarimeve të subjektit sa më lart, krijon bindjen, nga provat e administruara në proces, se subjekti Dritan Seci ka njohje dhe atij i janë dhënë në formë dhurate nga z. B. M një shumë prej 20.00 euro, e cila nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2014 si dhe në deklaratën e pasurisë,

shtojca 2, duke arritur në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarin të rremë dhe fshehje të pasurisë.

11. Në lidhje me pjesën takuese të bashkëshortes së subjektit, znj. D.A (S), si person i lidhur me subjektin Dritan Seci për apartamentin me sipërfaqe ** m², në bashkëpronësi, ndodhur në Bajram Curri.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tropojë²⁷ rezulton se në emër të shtetasve D. A, F. Al dhe H. A është regjistruar pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe ** m², ndodhur Bajram Curri, në zonën kadastrale ***, numër pasurie ****, e regjistruar në volumin *, faqe **.

Ky apartament është përfituar nga kontrata e shitblerjes e datës 29.1.2002 me shitës D, Gj, S dhe I. R dhe me blerës H, F dhe D. A me çmimin 350,000 lekë.

Nga ana e subjektit dhe e personit të lidhur me të, bashkëshortes së subjektit, znj. D. A (S), nuk rezulton e deklaruar pjesa takuese prej 1/3 të apartamentit në bashkëpronësi me prindërit e saj në deklaratat periodike të 2010 – 2016 dhe në deklaratën “Vetting”.

Pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se: *“Kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortes në kohën që unë nuk isha i martuar me të dhe as ajo nuk ka pasur dijeni se është bashkëpronare dhe nuk më ka informuar për këtë fakt. Pasi jemi informuar nga prindërit e bashkëshortes në lidhje me këtë fakt, me deklaratën noteriale të datës 6.9.2018, bashkëshortja ka hequr dorë nga bashkëpronësia në këtë pasuri dhe është bërë ndryshimi i pronësisë në zyrën vendore të regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.”*

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja D. A (S), nuk kanë bërë deklarin të mjaftueshëm, që konsiston në mosdeklarimin në deklaratat periodike vjetore të pasurisë dhe në deklaratën “Vetting”, të pjesës takuese prej 1/3 të bashkëshortes, në bashkëpronësi me dy prindërit e saj, në apartamentin me sipërfaqe **m² ndodhur në Bajram Curri, Tropojë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe e provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *“Përshatshmërinë për*

²⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2018, drejtuar Komisionit.

vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci”. Ky raport është deklasifikuar²⁸ në datën 30.10.2017.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione që subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi deklaratën për kontrollin e figurës të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Gjithashtu nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, për rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Inspektorati pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit duke rishikuar tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.07.2018, ky inspektorat ka përcjellë pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016.

I. Raporti për analizën e aftësive profesionale të subjektit, i kryer nga Inspektorati pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar te:

- 1) formulari i vetëdeklaramit, tre dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklaramit, dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;

²⁸ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., 30.10.2017.

3) të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe ndjek procedurën e parashikuar nga ligji.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Në tërësi, ai respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk i përdor në çdo rast të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Lidhur me ngarkesën sasiore, ai ka deklaruar se për periudhën 2013 - 07.10.2016 i janë caktuar për gjykim 804 çështje, nga të cilat ka përfunduar 738 çështje. Konstatohet se gjyqtari Dritan Seci ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesa vendimet gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjatë gjykimit, gjyqtari Dritan Seci identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre. Përgjithësisht zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor. Megjithatë, në disa raste janë konstatuar edhe parregullsi, të cilat në pjesën dërrmuese kanë lidhje me mangësitë në njohuritë procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Dritan Seci, janë paraqitur dy ankesa në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilat janë verifikuar.

Një ankesë e vitit 2013 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është konstatuar se gjyqtari ka shqyrtuar një çështje civile pa palë kundërshtare për 5 muaj e 7 ditë, duke tejkaluar afatin standard dymujor. Për këtë ankesë është konkluduar se nuk mbështeste përshtatshëm një procedim disiplinor dhe, për pasojë, i është regjistruar gjyqtarit për

vlerësim profesional dhe etik. Ankesa e dytë, e paraqitur në vitin 2016, e verifikuar për zvarritje gjykimi, është arkivuar pas verifikimit me arsyetimin se pretendimet rezultuan të pabazuara.

Përgjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtarin Dritan Seci nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e shortuara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Dosja 3 rezulton të lidhet me çështje të zgjidhjes së martesës, ku në vendimmarrje rregullohen pasojat lidhur me të miturit. Në rastin me të mitur është konstatuar se, ndonëse është përmendur prej gjyqtarit parimi i interesit më të lartë të fëmijës, procedura e ndjekur nga gjyqtari ka qenë me mangësi, sidomos për kryerjen e vlerësimit të nevojave të të miturit dhe, rrjedhimisht, konkludohet se gjyqtari e përmend parimin formalisht. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Konstatohet se gjyqtari Dritan Seci komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Konstatohet se subjektit Dritan Seci ka aftësi për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën gjyqësore. Nuk janë konstatuar vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, gjë që tregon produktivitetin e punës së tij në këtë aspekt.

II. Vlerësimi i aftësive profesionale bazuar te tre dokumentet e zgjedhura nga subjekti dhe te pesë dosjet e përzgjedhura me short

Komisioni analizoi tre dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht:

- vendimin penal nr. **, datë 23.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, që i përket prokurorisë kundër të pandehurës N. Gj., e akuzuar për veprën penale “Mashtrim në sigurime” të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal;
- vendimin penal nr. **, datë 10.11.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, që i përket prokurorisë kundër të pandehurit G. Gj., i akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, të parashikuar nga neni 191/3 i Kodit Penal;
- vendimin civil nr. **, datë 24.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, që i përket paditësit S. B., kundër të paditurit Filiali i Postës Kukës, Dega e Postës B. Curri, me objekt të padisë “Shfuqizimi i aktit administrativ. Rikthimi në vendin e mëparshëm të punës dhe rivendosjen e të drejtave të cenuara”, dhe në përfundim nuk konstatoi problematika apo parregullsi në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni analizoi pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura nëpërmjet procedurës së shortit dhe, pas verifikimit të kryer në katër prej tyre, konkretisht:

- çështjen penale nr. ** regj. them., datë 3.6.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropoje me objekt “Njohje e vendimit penal nr. ***, datë 7.2.2015, të Gjykatës Themelore Gjakovë, Kosovë, për deklarimin fajtor dhe dënimin e shtetasit shqiptar H. Q., me gjashtë ditë burgim”, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 17.6.2015;
- çështjen civile nr. *** regj. themeltar, datë 2.10.2014 regjistrimi, që i përket paditësit R. Rr., kundër të paditurit shoqëria “Shërbimi Përmbarimor Z”, me objekt të padisë “Kundërshtim veprimesh përmbarimore. Sigurim padie me pezullimin e veprimeve përmbarimore”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.10.2014;
- çështjen civile nr. *** (*****2016) regj. themeltar, datë 6.4.2016 regjistrimi, që i përket paditësit Z. M., kundër të paditurit DRSSH-së Tropojë, me objekt padie “Njohje vërtetësie e marrëdhënieve të punës. Vërtetësia e gjeneraliteteve të paditëses tek aktet e palës së paditur”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.5.2016;
- çështjen penale nr. ** regj. them., datë 5.5.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë kundër të pandehurve G. Gj., dhe G.Gj., të akuzuar për veprën penale “Shkatërrim prone në bashkëpunim”, e përfunduar me vendimin nr. ** datë 26.5.2014,
nuk konstatoi problematika apo parregullsi në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Në njërën prej dosjeve të përzgjedhura nëpërmjet procedurës së shortit, u konstatuan problematika si vijon:

❖ **Çështja civile nr. ** e regj. themeltar**, datë 17.3.2014, regjistrimi që i përket paditësit G. M., kundër të paditurës E. B., me objekt “Zgjidhje martesë me pëlqim reciprok të bashkëshortëve”, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 8.4.2014.

Gjyqtari, me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 8.4.2014, ka vendosur zgjidhjen e martesës duke miratuar aktmarrëveshjen e lidhur midis palëve. Vendimi ka marrë formë të prerë.

Në seancën gjyqësore të datës 8.4.2014, gjykata ka thirrur psikologun, me qëllim hartimin e aktit të ekspertimit psikologjik për fëmijën, nga e cila u kërkua një orë kohë për të bërë takimin me fëmijën dhe për të përgatitur raportin psikologjik. Raporti prej nëntë fletësh u dorëzua në seancë pas një ore.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e ndodhur në dosje, krijoi bindjen se çështja ka qenë e paragjykuar për arsye se caktimi i psikologes si eksperte u bë në të njëjtën seancë që u bë dhe dorëzimi i aktit të ekspertimit me diferencë kohore prej një ore. Në dosje mungon vendimi i ndërmjetëm për caktimin e ekspertit psikolog, për caktimin e detyrave, si dhe për administrimin e raportit të psikologut.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje konstatimin e Komisionit, për këtë çështje ka deklaruar se: *“Në lidhje me vendimin e ndërmjetëm ky vendim është marrë dhe mund të shihet nga procesverbali i seancës gjyqësore.*

Në lidhje me përgatitjen e raportit të psikologes në një kohë të shkurtër, nuk e kam paragjykuar aftësinë profesionale të saj, pasi e kisha të pamundur të gjeja psikologe tjetër për ta zëvendësuar. Duhet të mbahet parasysh edhe fakti se zgjidhja e martesës ka qenë me marrëveshje mes palëve dhe nuk kanë pasur konflikte me njëri-tjetrin dhe që vinin nga larg, pasi banonin në Durrës”.

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Pas analizimit të dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe pas deklarimeve të subjektit, Komisioni vëren se:

Ka mangësi procedurale në drejtim të mungesës së vendimit të ndërmjetëm të gjyqtarit për caktimin e ekspertit psikolog, caktimin e detyrave për psikologun, si dhe masën e shpërblimit të saj referuar nenit 105 të Kodit të Procedurës Civile (megjithëse në dosje ndodhet një deklaratë e psikologes, ku dokumentohet marrja e shpërblimit të saj);

Konstatohet mosadministrim i raportit të psikologes si provë në gjykim në vijim të procedurës së nisur nga gjyqtari për marrjen e kësaj prove;

Evidentohet fakti se, megjithëse seanca është caktuar në të njëjtën ditë, për një periudhë të shkurtër kohore vetëm një orë, psikologjia ka arritur ta pyesë fëmijën e mitur, si dhe

të përpilojë raportin psikologjik prej nëntë faqesh (brenda një ore), një kohë realisht e pamundur. Nga të dhënat e mësipërme duket sikur çështja ka qenë e paragjykuar.

Konkluzion

Komisioni konstaton mangësi të hapave proceduralë nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, në procesin gjyqësor me objekt “Zgjidhje martese me pëlqim reciprok të bashkëshortëve”.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Sipas të dhënave nga burimet arkivore pranë ish-KLD-së për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2009 përpiluar në bazë të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, ka rezultuar se për këto tre vjet subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, i janë cenuar 27 vendime gjyqësore nga gjykatat më të larta dhe respektivisht:

- për vitin 2007 i janë cenuar 12 vendime gjyqësore (7 çështje për themelin dhe 5 çështje për procedurë);
- për vitin 2008 i janë cenuar 10 vendime gjyqësore (6 çështje për themelin dhe 4 çështje për procedurë);
- për vitin 2009 i janë cenuar 5 vendime gjyqësore (5 çështje për themelin).

Ankesave të paraqitura pranë KLD-së për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci

Komisioni konstaton se janë depozituar 12 ankesa të tilla në Inspektoratin pranë ish-KLD-së, të cilat janë trajtuar nga ky institucion.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit përkatës, ka marrë në shqyrtim tri prej tyre nga ku ka rezultuar:

1. Ankesa e datës 18.3.2016 e shtetases S. P ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci.

Në ankesën e saj kjo shtetase ngre pretendimin për zvarritje të procesit gjyqësor dhe vendim të padrejtë. Nga ana e Inspektoratit të KLD-së u konkludua se, edhe pse është kapërcyer afati ligjor 3-mujor, nuk u konstatuan veprime të qëllimshme për zvarritjen e gjykimit.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës²⁹ dhe Gjykata e Lartë³⁰;

²⁹ Shiko në dosje përgjigjen nr. ** prot., datë 24.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Kukës, drejtuar Komisionit.

³⁰ Shiko në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 8.2.2019, të Gjykatës së Lartë, së bashku me dosjen gjyqësore drejtuar Komisionit.

Referuar pretendimeve të ngritura nga ankuesja S. P ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, për zvarritje të procesit gjyqësor si dhe vendim të padrejtë në procesin ku vëllai i saj, z. A. P, ishte në cilësinë e të pandehurit, nga ana Komisionit pasi u shqyrtua dokumentacioni përkatës u konstatua se shtyrjet e seancave gjyqësore janë bërë nga subjekti për shkaqe të arsyeshme, për shkak të mungesës së njoftimit të dëshmitarëve të thirrur nga prokuroria dhe nga gjykata në mënyrë të herëpashershme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. **, datë 15.2.2016, ka vendosur ndër të tjera “Deklarimin fajtor të të pandehurit A. P për veprën penale “*marshtrimi në kredi*” dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim”.

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër.

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni konstaton se kohëzgjatja e procesit gjyqësor tej afateve ligjore nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve me faj të subjektit, por për shkaqe ligjore që nuk vareshin nga subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezulton të ketë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

2. Ankesa e datës 29.3.2010 e fisit Rr. ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci.

Në ankesën e tyre, fisi Rr ankohet për një vendim gjyqësor me kërkues z. H. M, me objekt “Vërtetimi gjyqësor i faktit”, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të padrejtë, duke iu grabitur atyre pronën.

Kjo ankesë është trajtuar nga KLD-ja, e cila ka konkluduar se vendimi i gjykatës për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë është vendim deklarativ dhe, për pasojë, nuk mund të regjistrohet dhe as të ekzekutohet, duke i sugjeruar ankuesit që konfliktin ta zgjidhin me padi themeli.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni, pas shqyrtimit të dosjes gjyqësore të tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë³¹ ka konstatuar se bëhet fjalë për një proces gjyqësor me kërkues z. H. M, me objekt: “Vërtetimin e faktit juridik të pronësisë para vitit 1945 nga babai i tij të një sipërfaqe toke prej 35050 m².”

Në lidhje me legjitimitetin e palëve në proces, subjekti nuk ka kërkuar plotësimin/kthimin e akteve apo depozitim si provë të dëshmisë së trashëgimisë të babait të kërkuesit, duke legjitimuar kështu, në kundërshtim me ligjin, si kërkues dhe

³¹ Shihni në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 24.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, si dhe dosjen gjyqësore bashkëngjitur.

përfitues të pronësisë vetëm kërkuesin z. H. M e, për rrjedhojë, duke përjashtuar nga pronësia trashëgimtarë të tjerë të mundshëm.

Gjykata ka marrë në konsideratë, në cilësinë e provës, deklaratat dore të shtetasve E. K. dhe A. K. të lëshuara në datën 3.2.2009, për informacione apo fakte në lidhje me pronën, të thëna nga baballarët e tyre të cilët nuk jetojnë më, por jo të jetuara nga vetë deklaruësit.

Dëshmitarët e thirrur në procesin gjyqësor dhe ata që kanë lëshuar deklaratat e tyre, pa qenë pjesëmarrës në proces, nuk kanë paraqitur prova (certifikata pronësie) që të provonin pronësinë e pronave të tyre të pretenduara, kufitare me sipërfaqen e tokës së pretenduar, pronë e kërkuesit H. M.

Nga ana e kërkuesit nuk është depozituar dokument ligjor nga ZVRPP-ja përkatëse për të verifikuar gjendjen juridike të kësaj prone në momentin e ngritjes së padisë. Ky verifikim nuk është kryer as nga gjykata.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka deklaruar se: *“Vendimi në fjalë ka pasur karakter deklarativ dhe nuk është kundërshtuar nga ankuesit, të cilët i kanë pasur të gjitha mundësitë ligjore që të ndërhyjnë në proces si persona të tretë, por nuk e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë. Kjo dosje është inspektuar edhe nga KLD-ja dhe, në dijeninë time, është arkivuar”*.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Konkluzion

Komisioni, pas analizës së dosjes gjyqësore, si dhe pas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se veprimet e kryera nga ana e subjektit rezultojnë me mangësi të karakterit procedural që kanë të bëjnë me legjitimitimin e palëve në proces, si dhe me ndërtimin e ndërgjyqësisë.

3. Ankesa e datës 1.4.2017 e shtetasve F. N ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci.

Në ankesën e saj, znj. F. N, ankohet se gjyqtari Dritan Seci i ka mohuar të drejtën e marrjes dijeni të procesit gjyqësor, duke i mohuar asaj të drejtën për tu mbrojtur, pasi gjykimi është bërë në fshehtësi, duke vendosur qëllimisht adresën e gabuar në këtë kërkesëpadi me qëllim mosmarrjen dijeni se në Tropojë po zhvillohet një gjykim kundër familjes së saj.

Ankesa e kësaj shtetaseje është trajtuar nga KLD-ja, e cila ka konkluduar se ky rast nuk është objekt i veprimtarisë së Inspektoratit të KLD-së, por është objekt apelimi gjyqësor në gjykatat më të larta.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë,³² si dhe me Gjykatën e Apelit Shkodër.³³

Ankuesja, znj. F. N, ka qenë palë në një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe, konkretisht, në çështjen me paditës z. R. V, të paditur znj. F. N, z. A. N dhe z. A. N, me objekt “Detyrimin e palëve të paditura të njohin paditësin pronar etj.”

Në kërkesëpadinë e depozituar nga paditësi, ai ka shënuar si adresë banimi të të paditurve F. N dhe dy djemve të saj adresën “B. B”, Qendër Kamëz.

Në fletëthirrjet e datës 17.12.2015, dërguar nga gjykata për njoftimin e tyre për seancën e datës 29.12.2015 nga ftuesi i gjykatës në të tria fletëthirrjet është vendosur shënimi: “Nuk gjenden në këtë adresë, larguar në Norvegji, adresa nuk dihet”. Ky shënim nuk ka sqarimin se nga kush është marrë ky informacion, si dhe në të nuk shënohet personi që kishte dijeni për këtë informacion, duke i marrë shënimin ose refuzimin.

Gjykata nuk vijoi me verifikime të tjera në lidhje me identifikimin e adresës së saktë të të paditurve, por vijoi me procedurën e njoftimit të të paditurve me shpallje publike në ambientet e Gjykatës, si dhe në Bashkinë Kamëz.

Procesi gjyqësor vijoi në mungesë të të paditurit dhe gjykata me vendimin nr. **, datë 1.3.2016, vendosi “Pranimin e padisë së paditësit z. R. V, si dhe detyrimin e të paditurve të njohin pronar z. R. V etj...”

Znj. F. N, pasi vihet në dijeni të këtij procesi gjyqësor në mungesë të saj, ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë kërkesën për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit me argumentin se gjykata nuk ka bërë hetim të saktë në lidhje me njoftimet, të cilat janë bërë në adresë të gabuar.

Gjyqtari i çështjes S. U., me vendimin nr. **, datë 7.3.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses, znj. F. N, me arsyetimin se pala paditëse ka paraqitur si provë një deklaratë noteriale ku znj. F. N ka paraqitur si adresë Kamëz, Tiranë dhe jo adresën e paraqitur në kërkesën për rivendosje në afat dhe se procedura e njoftimit të akteve është bërë konform ligjit.

Kundër këtij vendimi kërkuësja F. N ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, pasi rihapi hetimin me vendimin nr. ***, datë 8.11.2018, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. **, datë 7.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke pranuar kërkesën e kërkueses F. N për rivendosjen në afat të ankesës kundër vendimit nr. **, të datës 1.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke arsyetuar ndër të tjera se:

³² Shiko në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 24.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, si dhe dosjen gjyqësore bashkëngjitur.

³³ Shiko përgjigjen nr. *** prot., datë 31.1.2019, të Gjykatës së Apelit, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

Vendimi nr. **, datë 1.3.2016, është zhvilluar në mungesë të palës kërkuese, znj. F. N, pa u njoftuar në bazë të ligjit.

Komisioni pas analizës së dokumentacionit konstaton se:

- Nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit, për sa i përket njoftimit të palëve në procesin gjyqësor, duke mos kryer një hetim të thelluar në lidhje me identifikimin e adresës së saktë të së paditurës, znj. F. N.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me konstatimet e mësipërme, ka deklaruar se: *“Ju sqarojmë se shënimi është vënë nga punonjësi i postës, i cili është personi zyrtar përgjegjës për dorëzimin e njoftimit dhe unë nuk kam pasur arsye të paragjykoj një punonjës shtetëror në ushtrimin e detyrës. Në gjykimin tim, nga ana ime janë respektuar kërkesat e ligjit për njoftimin e palëve në proces dhe nuk është përgjegjësi e imja nëse ai nuk ka qenë korrekt me njoftimin. Gjithashtu, nga ana ime është bërë njoftim me shpallje në Bashkinë Kamëz, pasi kjo ishte adresa që më kishin dhënë palët në proces”.*

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e dosjes gjyqësore, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se:

Në veprimet e subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, ka mangësi procedurale për sa i përket njoftimit të palëve në procesin gjyqësor, duke mos kryer një hetim të thelluar në lidhje me identifikimin e adresës së saktë të së paditurës F. N.

III. Denoncime nga publiku

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, në adresë të Komisionit janë depozituar dy denoncime nga publiku.

1. Denoncimi nr. *** prot., datë 29.10.2018, i bërë nga shtetasja S. B.

Shtetasja S. B ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci, për vendim të padrejtë, pasi me vendimin për rrëzimin e kërkesës së denoncueses për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, z. A. H, ngre pretendimin se gjyqtari Dritan Seci nuk ka marrë në shqyrtim provat për të provuar papajtueshmërinë e gjyqtarit të çështjes me palët në proces.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni:

Komisioni, pasi mori në analizë dosjen, si dhe materialin audio të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë,³⁴ ku kërkuesja, znj. S. B, i është drejtuar

³⁴ Shihni në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 22.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, së bashku me dokumentacionin bashkëngjitur.

gjykatës me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit A. H me arsyetimin se në një proces tjetër gjyqësor ky gjyqtar është në lidhje familjare dhe krushqie me dy nga të pandehurit që ai ka në gjykim, ku palë e këtij procesi është dhe vetë shtetasja S. B.

Në seancën e datës 1.11.2016, gjyqtari i çështjes, z. Dritan Seci, i ka kërkuar palës, znj. S. B, që të depozitojë provat ku ajo i mbështet pretendimet e saj dhe, në fund, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit me kërkuese S. B.

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezulton të ketë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. * prot, datë 28.9.2018, i bërë nga shtetasja C. B.**

Shtetasja C. B ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci, pasi me vendimin nr. ***, datë 10.9.2018, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për miratimin e vendimit për *pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve*.

❖ **Hetim i kryer nga Komisioni**

Nga shqyrtimi i kryer nga Komisioni i dosjes gjyqësore të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë,³⁵ rezulton se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datën 6.3.2018 është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2018, për veprën penale “Falsifikim dokumentesh”, pas kallëzimit penal të depozituar nga banorët e fshatit Dragobi të Njësisë Administrative Margegaj, si dhe nga shoqata “****”, kundër shoqërisë ndërtuese “A. U”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka dërguar kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2018, me arsyetimin se vepra penale “falsifikim i dokumenteve” është parashkruar dhe nuk rezulton ndonjë vepër tjetër penale e kryer.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë 10.9.2018, ka vendosur:
- *Pranimin e kërkesës së prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;*
- *Pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/2 për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale.*

³⁵ Shiko në dosje përgjigjen nr. *** prot., datë 22.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 4.12.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezulton të ketë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

1. Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe neni 51 i ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë; bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci:

- a. Ka kryer fshehje të pasurisë, deklaram të rremë, deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurisë.
- b. Nga analiza financiare, rezulton se për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, subjekti, me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomiko-financiare e bashkëshortes, kreditë, dhuratat, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreu V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Seci, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreu VI, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

❖ Nga vlerësimi i secilit prej tre kriterëve:

➤ nuk ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse ka kryer fshehje të pasurisë, deklaram të rremë, deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurisë, si dhe balancë

financiare negative për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, duke bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016;

➤ ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b, të ligjit nr. 84/2016;

➤ është “i aftë” duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 e 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/c dhe pikës 3 të nenit 58 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, me funksion kryetar/gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 11.3.2019

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland ILIA

Kryesues

Olsi KOMICI

Relator

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha

